



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Njoftim për mediat

Seanca dëgjimore me shoqërinë Hyundai Auto Albania për raportin “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të automjeteve të reja”

Tiranë, 17.06.2010 - Në përfundim të raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të Automjeteve të reja” dhe në zbatim të procedurave që parashikon Ligji nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sot në ambientet e Autoritetit të Konkurrencës u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqërinë Hyundai Auto Albania, palë nën hetim.

Përfaqësuesit e shoqërisë Hyundai Auto Albania paraqiten argumentet e tyre në lidhje me raportin e përgatitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës.

Pikat kryesore të diskutimeve u përqendruan në sjelljet e kësaj ndërmarrjeje në kuadër të paraqitjes së ofertave për procedurat e prokurimit të automjeteve të reja dhe mundësisë së bashkëpunimit me ndërmarrje të tjera në këtë treg.

Përfaqësuesit e Hyundai Auto Albania paraqiten argumentet e tyre në lidhje me këto çështje dhe pretendimet kundrejt konkluzioneve të raportit përfundimtar se kjo kompani nuk ka bashkëpunuar dhe nuk bashkëpunon me ndërmarrje të tjera për të koordinuar veprimtarinë e tyre në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja.

Në ditët e ardhshme në Autoritetin e Konkurrencës do të zhvillohet një tjetër seancë dëgjimore ku përfaqësuesit e shoqërisë Classic Volkswagen dhe Ultra Motors do të paraqesin pretendimet e tyre pas vënies në dispozicion të raportit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës.

Me përfundimin e seancave dëgjimore dhe vënien në dispozicion të të gjithë informacionit të nevojshëm, Komisioni i Konkurrencës do të marrë një vendim përfundimtar mbi raportin “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të automjeteve të reja”